

ANNA KOVE

**KAMBANAT E SË DIELËS**

TREGIME

---

BOTIMET TOENA



ANNA KOVE

KAMBANAT E SË DIELËS

**tregime**

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesje grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-277-68-8

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Këtë libër ia dedikoj kujtimit të gjysheve të mia,  
Andromaqi Kuteli (Kove) dhe Athina Rondo (Pupi),  
që më rritën me magjinë e rrëfenjave,  
të cilat ma ndikojnë jetën edhe sot.*



*Falënderojmë DEKRA-Akademie, që ndihmoi në botimin e këtij libri.*

LUTJE E PAMBARUAR





(X 1)

Dola para pasqyrës dhe s’po u besoja syve. M’u duk sikur pashë atë vajzën e vogël të para shumë viteve. Dukësia njëherësh bukur dhe e frikësuar. I qesha t’i jepja zemër. Hareja e madhe brenda gjoksit nisi të më shndërrohej pashpjegueshëm në ankth. Mora krehrin dhe instinktivisht nisa të kreh flokët, edhe pse s’do të shkoja askund tjetër, veçse në shtrat. Imazhi i ëndërrt i sime gjysheje m’u rishfaq sërish pas shpinës. Sa herë dilja para pasqyrës të bëja dialog me veten, më kujtohej ime gjyshe. Mbaj mend se çdo natë, para se të flinte, diç pëshpëriste.

“Nënokë, pse flet me zë të ulët?”

“Se këto fjalë kështu thuhën. Nuk duhet t’i dëgjojë njeri.”

“Po pse i thua, kur nuk do t’i dëgjojë askush?”

“Ja them Shën Mërisë. Ajo m’i dëgjon. Se më do shumë.”

“Po çfarë i thua? Edhe unë të dua shumë! Pse s’m’i thua mua?”

Pastaj m’u afrua; në dorë mbante diçka të mbështjellë me një batanije fëmijësh. E shtriu mbi

krevat, si të ishte fëmijë i vogël që donte kujdes se mos lëndohej. Mbylli perdet e errëta të dritares me një gozhdë të harkuar nga brenda, mbylli edhe derën e dhomës ku flinim të dyja.

“Mirë do të ishte të kishte edhe nga brenda çelës kjo derë e uruar”, - tha, pastaj më hipi mbi një stol para pasqyrës; m’i shprishi gërshetat që vetë m’i kishte thurur në mëngjes dhe më drejtoi të shihesha në pasqyrë.

“E sheh, sa e bukur je! Kështu do ngelesh gjithmonë, e bukur e me shpirtin e pastër të fëmijës në ata sy, nëse do ta duash shumë e do t’i lutesh përnatë Shën Mërisë.”

“Do ta dua, nënoke! Unë dua të jem gjithmonë e bukur”, - i thashë, ndërkohë që ajo hodhi sytë mbas perdeve të errëta të dritares.

“Zot, ki mëshirë për ne”, - tha këtë herë me zërin që mund t’ia dëgjoja qartë. E kisha hetuar se e përmendte shpesh fjalën “Zot”, edhe pse me shumë frikë. Dukej sikur kishte frikë se mos e dëgjonte edhe vetë, jo më të tjerët. Nuk e kuptoja pse, por e ndieja se s’duhej ta pyesja. Tërhoqi edhe një herë derën pranë vetes, si për t’u bindur se nuk hapej, nëse do ta shtynte kush nga jashtë dhe nxori nga poshtë rrobave të sirtarit të fundit të baules së saj diçka të mbështjellë me gazetë. Në letrën e zverdhur shihej qartë portreti i Enver Hoxhës, që përshëndeste me dorën lart dhe gishtat e harkuar para.

“Pupu”, - tha e tmerruar, - “si nuk e paskam parë me çfarë e kam mbështjellë?! Edhe kjo na duhet”. Nxori nga poshtë gazetës një kavanoz të vogël xhami, mbushur treçerek me ujë dhe sipër me vaj. Në mes të kapakut të verdhë dilte një fitil, bërë nga një kanotiere e grisur. Pjesa më e gjatë e fillit të pambuktë ndodhej brenda në barkun e vazos. Nxori një shkrepëse nga xhepi i fundit të saj të zi. Gjithmonë iu qepte fundeve të saj të gjera nga një xhep të brendshëm. Aty mbante një tufë çelësash të lidhur në një karficë. As sot nuk e di përse i kish gjithë ata çelësa. Ne, asgjë nuk mbanim të mbyllur në shtëpi; e vetmja gjë që hapej e mbyllej me çelës ishte baulja e saj. Me shkrepësen ndezi rripin e atij fitili të sajuar, të kandilit, siç e quante, dhe fiku dritën e dhomës.

“Nuk duhet të na shohë njeri”, - tha e pastaj u afrua edhe vetë para pasqyrës, mbi komonë e vjetër me dru arre të errët e shprishi gërshetat e veta, të mbledhur si gjarpërinjtë e ujit që rrinin në gjol kutullaç pas resmjeve. Flokët i kishte të hollë e të butë. Të valëzuar nga shprishja e gërshetave i dukeshin të dendur dhe ia mbulonin supet. Kushedi sa shumë vite kishte që nuk i priste, por vetëm i lante dhe i thurte çdo mëngjes. E hirta e thinjave nën dritën e qiririt e bënte të dukej krejt ndryshe. Ishte një ndjesi që edhe sot kur e kujtoj më mbushet shpirti me një ngazëllim që s’di ta shpjegoj. Nga poshtë batanijes nxori një ikonë druri. “Korë”, i

thoshte, dhe e mbështeti për pasqyre. Para saj gjendej kandili i ndezur.

“Shën Mëria tani do të dëgjojë lutjet tona. Ti do lutesh për herë të parë në jetën tënde. Me zë! Dhe me shpirt! Dhe do të bëhesh më e bukur se ç’je. Do të mbetesh e bukur gjithmonë, nëse lutesh. Kurrë mos e harro këtë natë.” E shihja nga pasqyra dhe përballë nesh, nga ikona, na shihte Shën Mëria, brenda një rrethi të florinjte, ndërsa nga pasqyra, unë dhe gjyshja, si hije, aq sa na lejonte flakëza e kandilit, dukeshim njësoj. Unë mbi stol dhe ajo në këmbë. Ma mori dorën në të sajën dhe më mësoi si të bëja kryqin. Dora më dridhej. Pëshpëriti me zë të ulët fjalët e uratës, dhe unë i përsërita pas saj.

Atë natë ndjeva se diçka ndryshoi në lidhjen time me të, por edhe në gjithë atë çka ishte bota ime, e një fëmije që i mësojnë se si të adhurojë një dashuri e si ta rrisë. Një dashuri që të jep lumturi të madhe, por edhe frikë të madhe, njëherësh. Askush s’duhet ta dinte se ç’kisha mësuar. Se ç’kisha bërë. Ç’kisha parë. “Askush”, - më tha ajo, dhe buzët iu drodhën sërish nga një lutje pendimi. “Askush?” “Jo. Sepse askush nuk të do më shumë se Shën Mëria”, - më tha. “As mami?” Nga ajo natë, kur më mësoi t’i lutem fshehur Shën Mërisë, filluam të flisnim gjithmonë para gjumit. Flinim të dyja në një dhomë. Mbase sot askush nuk e kupton dot sesi një fëmijë flinte në një dhomë me gjyshen, por atëherë ashtu ishin kohët. Koha më e bukur dhe më mistike e kujtimeve të mia

të fëmijërisë. Mezi prisja të vinte mbrëmja dhe t'i shtrihesha pranë.

Një natë më tregoi një histori të trishtuar:

“Kur linde ti, bijë, ky vend po ndahej me Zotin. Mbi këtë vend po binte mallkimi”.

“Po pse, nënoke? Çfarë do të thotë ‘po binte mallkimi?’”

“Në një vend që nuk bien kambanat, bie mallkimi”, - më tha. “Ti linde në javën e Pashkës. Prill. Po ne nuk i festonim dot hapur. Atë natë festuam, duke u fshehur me gëzimin e lindjes sate. Ti ishe ende pa emër. Të nesërmen e Pashkës jot ëmë të mori me vete dhe të pagëzoi fshehur në një kishë diku në jug, andej nga ishte vetë. Te porta e shtëpisë së Sekretarit të Partisë, atë natë të Pashkës, se kush kishte hedhur ca lëvozhga vezësh të kuqe. Lajmi mori dhenë. Qyteti i vogël ishte mbledhur grusht nga paniku. Dhe meqë e kishin pikasur se ne kishim bërë festë, kur u kthye ca ditë më vonë, nënën tënde e thirrën atje, në atë shtëpinë e spiunëve.

- Tregoji partisë, - i thanë. - Vajte në jug?

- Vajta.

- Festove Pashkën, pa u nise?

- Festova vetëm lindjen e vajzës.

- Po lëvozhgat e vezëve të kuqe pse i hodhe në derën e shtëpisë së Sekretarit të Partisë?

- Nuk kam hedhur asgjë, dhe ajo shtëpi buzë ujit nuk është e Sekretarit të Partisë, por e familjes sonë.

- Ajo shtëpi është e pushtetit popullor, ç’ju duhen juve dy shtëpi? - i tha vrazhdë njeriu i partisë. Ndjesia e pronës së fituar rastësisht, e të grabitur, te njerëzit që nuk e kanë pasur kurrë atë, i bënte ata edhe më agresivë me pronarët e vërtetë. Po vajzën pse e pagëzove në fshehtësi? Si dreqin i merrnin vesh të gjitha?! Ajo s’iu përgjigj asnjë pyetjeje. I kishin vënë përpara një letër dhe një laps, që të shkruante emrin e priftit. I thanë se nuk do ta linin të dilte nga ajo dhomë, as për të ushqyer foshnjën, pa shkruar emrin në letër. Dikur, kur po errej dhe ajo, e mbyllur atje në dhomën e “Degës së Punëve të Brendshme”, po ndiente dhimbje therëse në gjoks nga qumështi i papirë; e bashkë me dhimbjet po i ngrihej edhe temperatura. Nga mezi i natës e kishin gjetur shtrirë përtokë, pa ndjenja. Nga spitali erdhi në shtëpi të nesërmen. Ti qave shumë atë natë. Nuk kishim ç’të të jepnim të pije, se ende nuk haje. Mora pak sheqer sa thoi i gishtit të vogël dhe e futa në një napë të bardhë në formën e kokës së një biberoni dhe sa here qaje ta fusja në gojë, e thithje dhe qetësoheshe. Lusja Zotin që ai pak sheqer të mos mbarohej, derisa të vinte jot ëmë. Dikur u qetësove. Por, as nga qumështi i gjirit nuk pive më. E fute në gojë dhe sërish fillove të qash shumë. E sigurt, ai qumësht ishte hidhëruar. Si dukej, në atë natë torturash psikike, së bashku me gjakun, i kishin helmuar dhe qumështin.”

Asgjë s'më ishte dukur më magjepsëse se ajo mbrëmje kur mësova të lutem. Kohë më vonë, pas vdekjes së saj nuk u luta çdo natë, por veç në netët e trishtuara. Kur është i lumtur, njeriut s'i bie ndër mend lutja!

## (X 2)

Makina më ndaloi para këmbëve. Hipa me padurim dhe i çika paksa buzën e sipërme, më shumë duke i marrë erë sesa duke e puthur. Kisha menduar se duhet të bëja diçka me pamjen time për ta çuditur. Jo! Nuk kisha mundur dot kaq shumë sa ai, që dukej sikur i kishte hequr së paku 10 vjet vetes. S'e kishte më atë pamjen e mesoburrit, që po pret me durim e qetësi plakjen, por pamjen e një burri të ri, që s'pranon dot të ndahet nga hija e djaloshit. I freskët, i saporrUAR dhe i spërkatur me aromë. Ajri i makinës ishte mbushur gjithë dashuri. U ndjeva në çast si në një botë magjike. Një fill i padukshëm mistik ngadalë-ngadalë po na bënte bashkë të dyve në një udhëtim. Ja, ai vozit, ndërsa vështrimi im tretet larg nëpër pemë, që më duken si silueta njerëzish. Në fantazinë time më ngjante shpeshherë me një pemë. A mund të projektohet imazhi i një njeriu te një pemë. Pse jo? Një pemë me trung të gjerë dhe lëkurë me ashkla të plasaritura që ruajnë fort palcën, me rrënjë thellë në tokë dhe me kreshtën e madhe të degëve e gjetheve



të gjelbra, që e lejojnë diellin e ngrohtë ta depërtojë deri në ngjizjen e saj me tokën. E unë doja të isha, si në mite, nimfa e pemës, driada e saj. Të isha e lirë në trup, e bukur si të gjitha nimfat, e varur nga eliksiri që më jepte simbioza e jetës në dashuri me pemën. Të rrija aty dhe të thithja nga oksigjeni i saj, por edhe të mund të ikja larg, vetëm, aq larg, sa pema të mos vuante pa praninë time, por pastaj të ishim sërisht bashkë, të kapërthyera si në mite: nimfa dhe pema e saj. Ishin përjetimet e një çasti, kur një grua shkëputet nga realiteti thjesht e vetëm se e mrekullon natyra, apo kushedi se çfarë ide e pavetëdijes së saj.

“Ku po shkojmë?” - e pyeta, kur mendja m’u kthye aty brenda në makinë. Shkëputi vështrimin nga rruga një çast dhe sytë i ndriçuan fort. Ndjesia e të qenit i dëshiruar nuk mund të kalonte pa atë ngazëllimin që, nga brenda, nis e të shpërfaqet në fytyrë dhe duket sikur të rrjedh nga sytë, mbi buzë. Me dorën e majtë mbante timonin, ndërsa me të djathtën më shpupurishi flokët. Iu afrova paksa, me kujdesin e duhur që të mos e shpërqendroja, dhe ia mora dorën e djathtë mbi timen. Ndieja se lëkura nga aty po shpërhapte kënaqësinë e të prekurit dhe ndër pjesë të tjera të ndijimit. Pastaj ledhatova me lëvizje rrethore bulëzat e gishtave të mi me të tijat. Si i përmbante ky burrë aq fort instinktët? Guximi im mund të ishte edhe më i madh, sikur të mos kisha vazhdimisht frikën e shpërqendrimit nga timoni. Si për të më thënë se unë

s'mund të jem e pagabueshme në gjykime, gjeti një xhep rruge dhe ndali makinën. Ma rrëmbeu fytyrën mes pëllëmbëve, ma afroi pranë të vetës, dhe një masë e lëngshme buzësh përfshiu të miat. Ma kapi dorën dhe ma shtrëngoi fort duke kapërthyer gishtat.

- Cila është dëshira më e madhe që ke tani, - më pyeti, duke më thirrur në emër. Pranë tij, e papeshë, kisha një dëshirë shumë më të madhe t'i kundroja sytë, që i flakërinin nga iskra dëshirash, t'i puthja buzët e lëngështa, t'i kapërthehesha fuqisë së trupit mashkullor. Madje, kisha një dëshirë edhe më të madhe, që tejkalonte të qenët grua. Një dëshirë që vinte nga lumturia, por edhe frika se një ditë do të mbaronte ky pasion përpirës dhe këto përjetime ajri do t'i ktheheshin sërish tokës. Aty do të mbulohehin nga dheu i harresës. Me dhimbje. Si mbulojmë çdo qenie që ka qenë pjesë e shtrenjtë e jetës sonë. Unë doja t'ia lija ajrit gjithë ç'ndieja. Ai e kuptoi pamundësinë time për të folur mbase si pa dëshirë. Realiteti po më ushqente me një dashuri gati të pamundur. - Hë? - më ftoi sërish. Ç't'i thosha? Dëshirat më të mëdha qenkan dhe pamundësitë më të mëdha!

- Të di se ku po shkojmë, - e pyeta më zë disi të dridhur, pa ditur ç't'i përgjigjesha asaj pyetje të beftë.

- Drejt të pamundurës, mbase, - m'u përgjigj krejt shkurt dhe pa u zgjatur. Edhe tani që ndanim vetëm të dy ajrin mes nesh, më shumë heshtte sesa fliste. Por, në kësi kushtesh, kur e kisha aq pranë, heshtjen

e ndieja njësoj si fjalë të thëna bukur. Heshta dhe unë dhe nuk fola fare thujse gjithë rrugës. Në thelb isha njëri kureshtar dhe s'frikesha kurrë, kur e ndieja se diçka e panjohur më priste. E në këtë rast, përmes së panjohurës, mbase do të kisha mundësi ta njihja më mirë edhe atë vetë.

- Ende nuk ma the një dëshirë të madhe që ke në këto çaste, - insistoi.

- Më duaj, sa të mos jetosh dot pa mua! - i thashë, dhe u pendova në çast nga ajo fjali, që më tregonte gati-gati adoleshente naive.

- Hëm. Por, do të jetosh ti pa mua, - tha, dhe ma mbylli gojën me buzë, më tepër për të mos më lënë kohë fare të flisja pas tij. Ishim në krah të njëritjetrit dhe ndihesha si e papeshë tek ecja asaj rruge. Ndieja ajrin të më rrethonte të gjithën me harmoni shpërthyesë. Herë-herë ia fusja krahun si padashur dhe ai ma shtrëngonte me dorën e tij rreth belit. Pastaj shkëputeshim sërish, si për t'i dhënë mundësi frymëmarrjes të ritmonte natyrshëm. Ecëm duke shijuar pa fjalë kënaqësinë e hapave në trokun e zemrave. Pastaj harkoi krahun e tij të djathtë rreth qafës, duke më drejtuar gjithë trupin për nga një lulishte e vogël aty pranë, ku ca pleq po luanin domino dhe m'u bë i largët sërish.

*Si më tha? Se do të jetoja unë pa të. Pra ai mendon se unë nuk e dua mjaftueshëm, sa të mos e kem të pazëvendësueshëm? Këtë të ketë pasur ndër mend,*

*kur m'i tha ato fjalë? Pse do të jetoj unë pa të, kur ne duhemi?* Po e torturoja veten me këto pyetje të brendshme, ndërsa ai po i pyeste pensionistët për një bust të prishur nga komunistët në vitin 1947.

- Një përmendore prishur nga komunistët? Po, a nuk i ndërtuan vetë komunistët lapidarët dhe përmendoret pas luftës?

*Po sikur të ketë menduar se, ngaqë nuk është shumë tip seksual, kam nevoja përtej asaj që ai më jep dhe... Ah, jo deri këtu nuk mund të arrijë të mendojë asnjë burrë, edhe nëse nuk të do shumë.*

- Ku mund të ketë qenë lapidari?

Ai po pyet pleqtë, ndërsa pleqtë pyesin njëritjetrit. Po unë pse drejtin nuk i lë këto pyetje idiote që ia bëj pa fund vetes, dhe të përqendrohem më mirë se pse u rrethuam nga gjithë këta pleq këtu në mes të lulishtes? Busti? Përmendorja? Lapidari? Varri? Ja. Për këto po flitet më duket.

- Lapidari ka qenë para Shtëpisë së Oficerëve.

- Jo. Jo, - thotë një tjetër. - Ai u prish më vonë. Pasi u prishëm me kinezët. Nuk ishte lapidari i priftit tonë ai. Busti i një prifti shqiptar, i derdhur në bronz, që u shkatërrua po nga shqiptarët në 1947-n.

Pleqtë aty rreth nesh s'duhet të kishin qenë edhe aq të rritur më 1947-n, sa për të mbajtur mend aq shumë. Se ishin shumë të hallakatur në përgjigjet që jepnin. Pastaj thirrën një më të vjetër, nga një grup, që luante një lojë shahu aty pranë. Një nga ata që i dinte dhe

mbante mend të gjitha. Ai fliste e fliste pa pushim. E kisha shumë të vështirë të përqendrohesha, dhe pse tani isha bërë tërë sy e veshë.

- Po, po. E di. Si nuk e di. Lapidari i priftit ishte afër kishës së vjetër.

- Pra, e paskan prishur komunistët kur prishën kishat? - u hodh dikush.

- Po, jo, mor burrë. Kishat u prishën në 1967-n. Lapidari i priftit tonë u prish në 1947-n. Si ka mundësi aq herët, para se të prishej kisha? - pyeti dikush tjetër aty pranë.

- E prishën komunistët, por të urdhëruar nga serbët. Komunistët serbë nuk iu thanë këtyre tanëve të prishin kishën; se as kishat e tyre kurrë nuk i prishën. Por këta komunistët tanë në '47-n ishin si vëllezër me komunistët serbë. Dhe komunistët serbë, që të vrisnin për Zotin e tyre, donin që edhe Zoti ynë të fliste gjuhën e tyre. Priftin e vranë ata më 1928-n, se ky meshonte shqip, as në gjuhën e sllavit e as të grekut. Edhe shkrimet e kishës në shqipe, vinin e i prishnin diversantët serbë natën, e u vinin shenjtorëve tanë emrat e tyre sllavë. Po prifti prapë i shkruante shqip ditën. Deri ditën që e vranë. Thonë se donin t'i prisnin dhe kokën e t'ia çonin në Serbi. Populli këtu e donte shumë dhe ia bëri nderin edhe në kishë, edhe në xhami.

Këtu plaku ndaloi dhe na hodhi një vështrim të gjithëve, si për të parë në po e ndiqnim rrëfimin e tij

apo jo. Kur pa se edhe unë po e përpija gjithë ç'po rrëfente, vazhdoi:

- E kërkonin edhe të vdekur. E dini ç'bëri populli? E varrosi në varret e muhamedanëve, që të mos ia gjenin trupin, se prapë vinin diversantët natën, që t'ia gjenin kokën edhe t'ia prisnin së vdekuri.

- Çfarë? Një prift i varrosur në varret e myslimanëve? - e pyeta unë me habi dhe zë dyshues.

- Po, po, - tha. - Njerëzit këtu e deshën shumë në të gjallë. Ndaj ia ngritën lapidarin në të vdekur, - pastaj plaku na çoi te vendi ku kishte qenë dikur përmendorja e priftit, që pleqtë i thoshin "lapidar", dhe që komunistët e shkatërruan në 1947-n.

- Eh, - tha me dhimbje, - po ç'u kushtonte këtyre drejtuesve, që premtojnë qiellin në tokë për ca vota, ta ngrinin edhe një herë atë lapidar.

Prifti nuk ishte vetëm dëshmor i kishës, por ai ishte dëshmor i gjuhës shqipe dhe i atdheut. Iu mësonte shqip fëmijëve në kishë dhe kudo, të gjithëve, pa dallim. Thonë, kishte qenë vetë nxënës i Negovanit. Negovanin e dogji greku të gjallë, e këtë priftin tonë e vrau sllavi mu brenda në kishën e tij të vogël në Najazmë, aty pranë gjolit.

Prandaj nuk duhen harruar gjërat, - mor bir, vazhdoi, - e atë lapidarin ta venë prapë, siç e kishte ngritur populli i këtyre anëve, të krishterë e myslimanë bashkë. Së bashku duhet t'i bëjmë gjërat për shqiptari. Ata që s'na deshën dhe na vranë atëherë,

prapë s'na duan edhe sot. Ata që na i prishën varret, dhe na i zhdukën, e na i ndryshuan shkrimet e shenjta të të parëve në kisha atëherë, prapë na i prishin edhe kërkojnë të na i ndryshojnë edhe sot në gjuhën e tyre. Përmes shërbëtorëve të tyre. Ndaj edhe duan që ne t'i harrojmë ca gjëra. Të harrojmë të vërtetat tona, të shkuarën tonë, martirët e vërtetë të vendit. Po mirë komunistët, që i harruan dhe i shkatërruan, po edhe tani këta që shkojnë e vijnë nëpër pushtete nuk po i bëjnë mirë fare ca gjëra, - këtu zëri iu mpak dhe kuptoi se tani muhabeti do bëhej më i rrezikshëm po të vazhdonte, ndaj parapëlqeu të bënte një pushim nga rrëfimi, duke pyetur: - Po, ti, pse interesohesh kaq shumë, mor bir?

Hë, pra, mendova dhe unë me vete. Pse ishte kaq i interesuar? Në vend të shijonim çastet tona të përbashkëta vetëm, rrinim e dëgjonim histori me priftërinj dhe komunistë.

- Prifti i Najazmës ishte gjyshi im, - tha. - As im atë s'e mbante mend fare. Dhe vdiq me brengën se nuk ia pa dot as varrin. Të pyesje në atë kohë për varrin e një prifti, të fusnin në varr të gjallë. Ose të linin siç e lanë tim atë. Të jetojë as mbi varr e as nën varr. As i vdekur e as i gjallë.

Pasi tha këto fjalë, unë e pashë në sy. Ai po lotonte. Ma shtrëngoi instinktivisht dorën. Burri i fortë befas u bë fëmijë i ndjeshëm, që kishte nevojë për t'u kapur diku. Pra, përveçse humbjes tragjike të gjyshit, ai

kishte edhe brengën e jetës së pajetuar të të atit. Ai u drodh. U drodh edhe dora ime brenda pëllëmbës së tij.

*Si tha? E kishte gjysh? Ata që s'e deshën dhe e vranë gjyshin dhe atin tim atëherë dhe tani s'më duan dhe do më vrasin edhe mua. Bobo! Kështu tha? Jo. Jo. Ishte pak më ndryshe. S'di si ndihem. Po unë pse nuk pyes atë si ndihet? Ja, ta pyes, së paku, si më pyeti ai. Por para se ta pyes, flet ai vetë i pari, pasi është përshëndetur me pleqtë aty në lulishten, ku dikur ishte përmendorja e Priftit të Najazmës, gjyshit të tij, që e kishin shkatërruar komunistët, siç i thanë pleqtë. Dhe, me dorën e vet, i ati i një njeriu me shumë pushtet politik e lidhje kriminale sot, si më tregoi ai me zërin plot ankth:*

- Je e lirë të mos më ndjekësh pas. Unë e kam shumë të komplikuar jetën.

- Kam frikë se s'po të kuptoj dot plotësisht.

- E di. Askush nuk do t'i kuptonte ca gjëra, edhe po t'i thosha.

- Po thuaji, se mbase ndihesh më mirë.

- Por, mos kujto se do të ndihesh ti më mirë, po fola unë.

- Gjithsesi, diçka duhet të ma thuash.

- Jeta ime është shumë e kontrolluar. Mbase edhe e rrezikuar.

- E kontrolluar? - pyeta sikur nuk po kuptoja. Por në fakt e kuptova mirë. Dhe kjo m'i bënte të



shpjegueshme edhe të gjitha ato situata të ankthit të tij të vazhdueshëm. Madje dhe paplotmërinë e ardhjes së tij tek unë. Në çast ndjeva frikë të madhe. Për atë? Mbase, por në vend të thosha ndonjë gjë, që të mund ta ndihmonte, apo të mund ta ngacmoja për të vazhduar më tej rrëfimin e tij, e pyeta në mënyrë krejt vetanake:

- Po jeta ime, a rrezikohet, nëse të ndjek?
- Nuk e di. Edhe mundet.
- Edhe mundet?

Toka m'u lëkund nën këmbë. Këmbët m'u drodhën dhe nuk isha e zonja të hidhja asnjë hap. As ta ndiqja e as të kthehesha mbrapsht.

- Është i vështirë shumë rrugëtimi drejt identitetit, - më tha në fillim. Po unë pse të kisha frikë? - Rrugëtime të tilla nuk janë të mjaftueshme vetëm. Por, as kur ke frikë, - më tha pasi kuptoi dyzimin tim.

- Eja të ikim nga ky vend. Ne mund të marrim mbrojtje dhe të jetojmë të sigurt diku gjetkë, larg këtij rreziku, - i thashë.

- Jo. Unë nuk iki. Ata atë duan, që ne të ikim. Ta braktisim vendin. Që të bëjnë ç'të duan me të shkuarën tonë, me vendet tona të shenjta, me emrat tanë, me të sotmen dhe të ardhmen tonë. Na e morën identitetin dikur me zhbërje, pastaj me plumb e me shkatërrim, tani duan të na përzënë.

Unë iu luta shumë të iknim. Se ç'kisha një parandjenjë të keqe.

- Po të ikim, do të mund të shkruanim e t'i rrëfenim të gjitha pa frikë e në liri, - i thashë. - Që asgjë të mos harrohej.

- Shkruaji ti, - më tha. - Të gjitha. Shkruaji ditët tona, netët tona. Çdo gjë që është kaq e bukur. Shkruaji dhe emrat kur i thërrasim në ekstazë, dhe Zotit kur i lutemi shqip. Kështu, të paktën, s'do na e vrasin dot dashurinë. As lutjet...

Ndjeva se ende diçka më fshihte, por nuk fola më dhe e ndoqa pas në heshtje.

(X 3)

Gjithmonë kur ndihesha kështu, e pasigurt, kisha dëshirë të vishja fustan të bardhë, pavarësisht viteve, aq më pak stinës, si për t’i dhënë siguri vetes përmes detajeve... Dhe, gjithherë, më kujtohej ajo kohë e largët, kur nata ishte si e veshur me mister, dhe mezi prisja pastaj të zbardhte mëngjesi, që të hapej gati në fshehtësi një sënduk druri arre, dhe prej aty ajo të nxirrte një fustan të gjatë e të zi kadifeje, një peliçe të zezë, që s’di pse ime gjyshe i thoshte “sako”, dhe një kapelë, që vetëm sa dilte dhe futej në sënduk sërish, pa u vënë kurrë mbi kokën e saj. Kapelat si ajo e gjyshes sime, që e kishte sjellë para çlirimit nga Rumania, s’të linin t’i mbaje më. Të gjitha rrobat i kishte të asaj kohe, të gati 40 vjetëve më parë, që i ruante dhe i pastronte me shumë kujdes. Gratë e reja aso kohe visheshin si burrat, të gjitha njësoj dhe pa asnjë gjurmë femërore në veshjen e tyre. E as mirëqenie mikro-borgjeze, siç i thoshin atë kohe, nuk duhet të reflektonin. Gjyshja e vinte kapelën mbi kokë, shihej në pasqyrë dhe e fuste sërish në sënduk. Thjesht sa të plotësonte ritualin.

Pastaj mbështillte në një napë të bardhë ca arra, ca gështenja, pak grurë të zier, temjan, dhe ca gjethe dafine. Ajo, e veshur e gjitha në të zeza, ndërsa unë e veshur me një fustan leshi të bardhë, që ma kishte thurur vetë me grep. Solemnitet gati mistik. Bardh' e zi, niseshim për t'i bërë vizitë një bote tjetër... Asaj më të panjohurës. Botës së të vdekurve, e cila kishte shumë rëndësi për time gjyshe.

Këto po ndërmendja, kur ankthi i terrtë i gjithë natës filloi të bëhej njësh me zbardhjen e mëngjesit. Kërkova në raftin e rrobave një fustan leshi të bardhë, thua se ai do më ndihmonte të zhvishja mendimet nga terri i tyre. Ndihesha e sigurt nën atë ngrohtësi *pure wooll*, dhe më dukej se dëgjoja zërin e dashur, të më pëshpëriste si dikur në fëmijëri: “Si engjëllushe dukesh!”.

Ndodhi që e pashë si në ëndërr rrjedhën e asaj dite në të zbardhur: ai do të vinte i veshur në kostum të zi, pasi të kthehej nga katedralja, ku do të ndizte atje tre qirinj, si më kishte thënë. Pastaj do nisnim udhëtimin tonë të bukur drejt atij qyteti përrallor, qytetit të çokollatave më të mira në botë. Nuk do t'ia nisim nga punishtja e parë e çokollatave magjike, as nga shtëpia e kompozitorit të famshëm, nën tingujt e sonatave të të cilit na kishte zënë gjumi disa herë të përqaftuar. Jo.

- Nga Katakombet, - më tha ai.

Si dreqin s'e kisha menduar edhe këtë si një nga dashuritë e fshehta, që na mbante padukshëm ende

të lidhur bashkë: Ime gjyshe dhe bota e panjohur e nëntokës me dashuritë e fshehta të saj. E magjishmja, që nuk duket sipër tokës. Ai nuk po vinte, e unë tani po i frikeshja ankthit të pritjes, kur ajrin e çau zhurma ulëritëse e ca sirenave, që nuk po e kuptoja në ishin të urgjencës apo të policisë, vetëm se dritat e tyre vibruese m'u përplasën në sy, aq sa më verbuan; gjithçka m'u bë terr, këmbët m'u morën, mendja më çoi drejt një realiteti *deja vu*:

*Është një zog, që s'po e pushon këngën e tij! Apo është vaji i tij? Përballë dritares, më ndjell monologun më të shëmtuar me veten. Si më tha ashtu? Se më donte aq shumë sa, po të iki prej tij, do të vdesë?*

*- Pse ma përmend vdekjen, zemër! - i them.*

*- Vetëm nga dashuria e madhe përmendet vdekja, kur je shumë i lumtur. S'e kupton? - më përgjigjet...*

*E, si ta kuptoj?! Si u treguaka dashuria e madhe, përmes gjëmës së madhe! Ah, ky korb, që s'po më lë rehat të shijoj në mendime llastimet e fjalëve të tij! Po, pse më qenka fiksuar vetëm kjo fjalë, me gjithë përkëdheljet, që edhe fjalori i përrallave me princesha do t'i kishte zili?! Kjo natë qenka e tmerrshme edhe e terrshme! Nuk mund ta shquaj dot, ku ndodhet shpendi që m'i bën shoqëri vetmisë. Po më hallakaten mendimet andej nga s'duhet. S'jam në gjendje të mendoj bukur, po nuk e hoqa qafe këtë zë të shëmtuar, që më çokanis në majë të kokës. Edhe ky telefon po kuis njësoj si korbi:*

- Për ç'zog më flet?

- Është një korb i zi.

- Si e sheh në këtë natë terr se është korb, edhe i zi, madje?

- Letërsia dhe baladat thonë se korbi është i zi? Dhe ogurzi.

- Jooo. Thjesht, të paralajmëron për diçka! Nuk është e thënë të jetë paralajmërim ogurzi. Korbi është lajmëtar i perëndive. Zog diellor, i kuq.

- Kurrë s'mund ta parafytyroj dot një korb të kuq!

- Përfytyroje ashtu, edhe fli! Natën e mirë!

Jam gjysmë fjetur e gjysmë zgjuar. S'e kam fare idenë e orës. Qepallat e rënduara s'po i binden përpëlitjes së zgjimit. Një pjesë imja është ende pre e kushedi ç'ëndrrash, kurse pjesa tjetër pre e trandjes nga mbipesha e ditës që po lind. Në përjetimet e gjysmës sime të ndërgjumur trembem nga do zhurma, që më dukej se i dëgjoja ndonjëherë kur kridhja kokën thellësive të detit. Ndjesia e dridhjes së panatyrshme të ujit më mbështillte në fund të barkut lëmshinj të mëdhenj ankthi. Forca e përjetmit të një zëri të afërt, që vinte nga larg, dhe e rrymave ujore, shkulumonin brenda meje vibrime të papërballueshme malli. Dridhem dhe unë bashkë me ujin. Në fakt, po dridhem në shtrat. Sa mirë që s'qenkam në ujë mendova, duke u shkundur paksa nga dremitja. Por, e njëjta zhurmë, pothuaj gati në të njëjtën kohë, lemeris edhe pjesën time të porsazgjuar. Po dridhet telefoni celular.